

KONFERENCA “GLOBALIZIMI DHE EKONOMITË NË ZHVILLIM”,

Organizuar nga Banka Kombëtare e Kroacisë në Dubrovnik, në 28-29 qershor 2001.

Kur erdha në këtë vend të këndshëm për të marrë pjesë në diskutimin mbi këtë temë interesante, po vrisja mendjen se si ta filloja prezantimin tim. Dialogoja me veten dhe mendoja se do të ishte mirë që ta sillja atë këtu dhe ta ndaja me ju. A erdhi globalizimi në vendin tim aq natyrshëm sa në ekonomitë e tjera në zhvillim (si një proces i ndërveprimit të tregjeve, teknologjive etj.)? A kanë popujt në të gjitha vendet dhe në të gjitha kohërat të njëjtin mendim për këtë proces?

Kam gjetur në një material të shkruar nga Irwin-i, një koment plot kuptim ku duket qartë mëdyshja në një anketë bërë opinionit publik : “ ka një mbështetje të fuqishme të publikut për tregtinë ndërkombëtare, kur ajo përshkruhet në kuptimin e gjerë dhe kur nuk i referohet politikës tregtare.

Gati 70 për qind e amerikanëve besojnë se tregtia është e mirë për ekonominë amerikane. Megjithatë, kur publiku pyetet për një iniciativë tregtare të veçantë siç është për shembull, NAFTA..., shkalla e përkrahjes ulet në mënyrë të ndjeshme”.

Mendoj se kjo ishte situata kur ne hymë në botën e globalizimit. Fillimi i tranzicionit në vendin tim mbështetej nga një entuziazëm shumë popullor mbi përfitimet që do të gëzonte vendi . S’kishte llogari për të bërë dhe s’doli nevoja për një politikë tregtare të mençur dhe të përcaktuar mirë, sa kohë që zor se mund të gjeje ndonjë ndërmarrje që të punonte apo ndonjë fermë që të konkurronte.

E gjithë ekonomia e vendit ishte në kolaps. Politika tregtare ishte modeluar thjesht duke marrë parasysh buxhetin.

Çdokush besonte se politika më e matur për t’u ndjekur ishte pikërisht hapja e kufijve. Por, ndërsa ekonomia filloi të lëvizte dhe grupet e interesuara u krijuan, presioni për më tepër mbrojtje u shndërrua në çështje të debatit politik.

Zërat e kundërshtarëve u intensifikuan dhe numri i përkrahësve u rrit.

Ajo ç'ka zhvillimet e dekadës së fundit të tranzicionit na mësuam ne ishte : Në një botë të globalizuar, ti nuk mund të qëndrosh i vetëm. Në momentin më të parë që ti e pranon atë si parim, përzgjedhjet e politikave janë të kufizuara.

Edhe periudha përpara tranzicionit nuk ishte një ekonomi pa probleme për Shqipërinë. Por, natyra e problemeve me të cilat ne u përballëm si një ekonomi e re e një vendi në tranzicion, ishte plotësisht e ndryshme. Monedha për shembull, ishte e pakonvertueshme: nuk kishte probleme të tilla me bilancin e pagesave dhe transferimin e kapitalit. Menjëherë sapo ne liberalizuar vërshimin e kapitalit dhe lamë të lirë regjimin e kursit të këmbimit, përgjigja e përgjithshme ekonomike ishte pozitive: u nxitën më shumë eksporte dhe prodhimi u rrit në mënyrë të dukshme etj.. Investimet e huaja direkte dhe huatë në valutë të huaj që iu dhanë firmave vendase kontribuan në rritjen ekonomike. Megjithatë, i gjithë procesi i tranzicionit, u shoqërua me një ekspozim, gjithmonë në rritje, ndaj lëvizjeve të kursit të këmbimit si dhe një borxhi të jashtëm të lartë.

Shqipëria është vendi që ka më shumë banka me kapital të huaj. Për më tepër, privatizimi i bankës së fundit shtetërore më të madhe në Shqipëri, Bankës së Kursimeve, do ta shndërrojë sistemin tonë bankar në një sistem plotësisht dhe kryesisht në pronësi të të huajve. Këto prirje të brendshme dhe rajonale që po kalon sistemi bankar, megjithëse të mirëpritura, për arsye se ofrojnë më shumë mundësi dhe përfitime, bëjnë thirrje për më shumë bashkëpunim me autoritetet mbikëqyrëse dhe më shumë transparencë në operacionet bankare. Në të kundërtën, prirjet e rajonizimit përfaqësojnë një shtrat të ndjeshëm nëpërmjet të cilit, krizat e mundshme të vendit, si bankare dhe ato të monedhës, mund të përhapen dhe të ushtrojnë një efekt infektues në sistemin bankar dhe në të gjithë ekonominë e një vendi.

Ky është një shqetësim edhe në nivel ndërkombëtar. Të paktën vetëm gjatë dekadës së fundit ne kaluam tre kriza të mëdha: krizën europiane të fillimit të viteve 90; krizën latino - amerikane që lindi në Meksikë në mes të viteve '90; krizën në Azinë Lindore, e cila u përhap në Rusi dhe Brazil në dy - tre vitet e fundit. Lëvizjet e kapitalit privat, duke qenë në të njëjtën kohë, herë shumë të mëdha dhe herë shumë të vogla mund të destabilizojnë. Mezi presim të shohim më shumë reforma, me qëllim që të përmirësohet perspektiva për stabilizimin e sistemit global financiar në të ardhmen.

Ndërkohë që njohim përparësitë e globalizimit, ne duhet të merremi dhe me humbjen që rrjedh prej tij. Globalizimi i rrit të ardhurat dhe pabarazitë sociale brenda vendeve; ai i lë disa vende, e patjetër dhe disa grupe njerëzish prapa. Prandaj, ne jemi dëshmitarë të protestave kundër globalizimit si në botën e zhvilluar dhe në atë në zhvillim. Çështje tepër e ndjeshme është për shembull lëvizja e krahut të punës në procesin e zgjerimit të Bashkimit Europian. Në këndvështrimin tim, emigrimi ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në ekonominë e vendit tim, si dhe në ato ekonomi ku punojnë emigrantët shqiptarë. Greqia për shembull e ka vlerësuar rolin e emigrantëve shqiptarë në ekonominë e saj si shumë të rëndësishëm (hezitoj të jap shifra të sakta, por është mëse e sigurt që është miliarda usd). E ndërsa vendet dhe qeveritë e njohin rolin e tij pozitiv, zërat kundër emigracionit rriten vazhdimisht.

Unë besoj se ekonomia do të jetë më e integruar dhe më e ndërthurur, megjithë zërat e kundërshtarëve. E rëndësishme është të shihen elementet e përgjigjes se : “Si duhet të përballemi ne me këto qëndrime që nuk përputhen kundrejt ekonomive që janë drejt rrugës së konvergimit?”

Së pari është edukimi: për të sqaruar dhe analizuar shumë më gjerësisht se cili është në fakt realiteti i ndikimit të globalizimit.

Fakti që, nëse do ta vinim në balancë, duket në mënyrë të qartë që përfitojnë të gjitha vendet dhe shumica e grupeve, prandaj, në tërësi është pa dyshim e dëshirueshme dhe duhet që të punohet më gjerësisht, veçanërisht në ekonominë e vendeve në tranzicion.

Pjesa e dytë e përgjigjes duhet të jetë një njohje e ndershme dhe pranimi i faktit se do të ketë humbje dhe të humbur. Për një kohë të gjatë, ata që bëjnë pjesë në anën pro-globalizimit, u përpoqën që ta injoronin dhe ta mohonin këtë fakt, por kjo në mënyrë të qartë duhet të pranohet.

Ajo vjen nga teoria ekonomike standarde, vazhdon tek vështrimi jashtë dritares dhe ndikon brenda shumë prej vendeve tona. Kjo, nga ana e vet do të thotë se duhet të bëhet diçka që të të ndihmojë të trajtosh humbjen dhe të humburit. Një ekonomi e hapur është një ekonomi që të ofron mundësi më të mëdha.

Popujt mund ta rrisin statusin e tyre ekonomik dhe shoqëror shumë e më shumë, për arsye se shoqëria jonë është një shoqëri në lëvizje. Në anën tjetër, shumë e më shumë popuj mund të dështojnë.

Në kuptimin e gjerë, kjo kërkon politika mbrojtëse sociale më të mira në shumë nga vendet tona, si dhe programe që do të ndihmojnë në rregullimin e keqshpërndarjes, të shkaktuar qoftë nga globalizimi qoftë nga forca të tjera të ndërlidhura. Mungesa e kuadrit mbrojtës tranzitor si për papunësinë, sigurimet, pensionet etj. përballë goditjeve të shkaktuara nga globalizimi, shkaktojnë ankth dhe çoroditje të mëdha. Ne duhet të marrim në konsideratë më me shumë kujdes, se si ndikohen grupet e ndryshme dhe çfarë programesh mund të adoptohen për të lehtësuar mungesën e mundësive.

Ndërsa ekonomia bëhet gjithmonë e më shumë dixhitale dhe e orientuar nga dija, ne na kërkohet që të krijojmë vende pune për njerëzit, arsimimi i të cilëve vjen në rënie.

Për këtë arsye, një element tjetër dhe më thelbësori i kësaj, (përgjigje) është krijimi i programeve të trajnimit dhe edukimit, që të fuqizojnë të gjithë komponentët e popullsisë sonë, me qëllim që ata të përfitojnë nga globalizimi dhe jo ta ndjejnë veten viktime të tij.

Programe të tilla duhet t'i japin mundësi popullit që të përfitojë nga përparësitë e fenomenit dhe të bashkohet me të, e jo ta kundërshtojë atë.

Së treti, ne duhet që, më me shumë kujdes të ndjekim reformat e arkitekturës financiare ndërkombëtare. Paqëndrueshmëria e monedhës, prek një masë të madhe të popullsisë sonë, në kushtet kur kursimet e tyre në valutë rriten. Ajo ndikon në çmimet në vend dhe si rezultat i kësaj përbën një potencial që destabilizon dhe kompromenton politikën e brendshme. Ne dëshirojmë të shohim më shumë stabilitet të monedhës dhe të tregjeve financiare, i cili kërkon një koordinim më të mirë të politikave ndërmjet lojtarëve kryesorë.

Së fundi, elementi i katërt është që të rifillojë liberalizimi i vërtetë shumëpalësh i të gjithë sistemit global dhe rajonal tregtar. Zhvillimet politike në rajonin e Ballkanit, gjatë dekadës së fundit e në vazhdim, përbëjnë një çështje të madhe me shumë interes. Filozofia jonë është që të heqim pengesat që ekzistojnë midis vendeve të rajonit tonë dhe të ecim së bashku në rrymën e ekonomisë globale.